REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 35, datë.29.05.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
"IMPIANT GJENERUES I ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOTAIKE "GLOW SOLAR", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË FIER

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Glow Solar" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Impiant gjenerues i energjisë elektrike fotovotaike "Glow Solar", me vendndodhje në Bashkinë Fier, me subjekt zhvillues shoqërinë "Glow Solar" sh.p.k.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

E D I R A M A

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

ENEA KARAKAÇI

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 01 /10/ 2026